




Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac – Municipality of Rahovec

KRYETARI I KOMUNËS

Presednik Opštine – Municipal Mayor

**LISTA E VENDIMEVE TË MARRA NGA KRYETARI I KOMUNËS SË RAHOVECIT,
Z. SMAJL LATIFI**

NGA DATA 09.12.2024 DERI MË 13.12.2024

NR.	EMRI I VENDIMIT	NR. I PROTOKOLLIT
1.	Vendim për punë shtesë	NRP-02-5087-2024
2.	Vendim për themelimin e komisionit të pranimit për kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese	NRP-02-5088-2024
3.	Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës	NRP-02-5090-2024
4.	Vendim për thjeshtëzimin e shërbimeve në Komunën e Rahovecit	NRP-02-5091-2024
5.	Vendim për punë jashtë orarit të rregullt të punës	NRP-02-5092-2024
6.	Vendim për aprovimin e mbështetjes	NRP-02-5095-2024
7.	Vendim për refuzimin e mbështetjes	NRP-02-5096-2024
8.	Vendim për emërtimin e personave zyrtar, autorizues, zotues, certifikues, pranimeve për administratë, shëndetësi dhe arsim për vitin 2025	NRP-02-5097-2024
9.	Vendim për qasje në dokumente publike	NRP-02-5098-2024



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 35 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik dhe nenit 37 të Ligjit Nr. 05/L-068 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 63, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa për punët shtesë dhe punë të paparapara e menaxherit të projektit dhe mbikëqyrësit të drejtëpërdrejtë me Nr. Prot. 3705 të datës: 5.12.2024, në projektin "Ndërtimi dhe renovimi i QMF-ve dhe AMF-ve - Ritenderim" me Nr. të Prokurimit 623-23-6893-5-2-1 dhe Nr. të Brendshëm 623-23-030-5-2-1 në shumën prej 8,321.50€ (tetë mijë e treqind e njëzet e një euro e pesëdhjetë cent).
2. Ky vendim merret, pasi që është konstatuar nga mbikëqyrësi i drejtëpërdrejtë dhe menaxheri i kontratës së projektit dhe verifikimit të gjendjes në terren, se projekti është në fazën përfundimtare dhe për t'u funksionalizuar është e nevojshme që të kryhen punë shtesë.
3. Obligohet Sektori i Prokurimit që t'i ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për zhvillimin e procedurave sipas ligjeve dhe akteve nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Zyra e Prokurimit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Menaxheri i Projektit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Zyrës së Prokurimit,
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,
- Menaxherit të Projektit,
- Mbikëqyrësit të drejtëpërdrejtë, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 5088 Nr. i faq/Br.str/No.pg 11

Data/Datum/Date 9 / 12 / 24

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 44 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 21/2023"), nenit 13 të Rregullores (QRK) për Procedurën e Pranimit të Nëpunësve të Shërbimit Publik në Sektorin e Shëndetësisë dhe nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, të datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për themelimin e komisionit të pranimit për kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese

1. **Themelohet** komisioni i pranimit për kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese të shërbimit publik në Sektorin e Shëndetësisë në Komunën e Rahovecit, në këtë përbërje:
 - 1.1. Etnik Popaj – Jurist në QKMF-në në Rahovec, kryesues;
 - 1.1.1. Njomëza Fazliu – Udhëheqëse e Sektorit të Tatimit në Pronë, zëvendëskryesuese;
 - 1.2. Arben Koshi – Drejtor i QKMF-së në Gjakovë, anëtar
 - 1.2.1. Ymret Reshiti – Drejtor në Qendrën për Punë Sociale në Rahovec, zëvendës;
 - 1.3. Afrim Krasniqi – Drejtor i QKMF-së në Malishevë, anëtar;
 - 1.3.1. Shadat Ukaj – Shef i Sektorit për Kulturë, zëvendës;
 - 1.4. Sale Bytyqi – Drejtore e QKMF-së në Suharekë, anëtare;
 - 1.4.1. Ylfete Kryeziu – Udhëheqëse e ekipit të SAS-it në QPS, zëvendëse;
 - 1.5. Mevlyde Kafexhiu – Zyrtare e Personelit në QKMF, anëtare;
 - 1.5.1. Agron Thaqi – Udhëheqës i Menaxherit i Burimeve Njerëzore, zëvendës.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit të cekur në pikën 1 të këtij vendimi janë të përcaktuara në Ligjin Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren (QRK) për Procedurën e Pranimit të Nëpunësve të Shërbimit Publik në Sektorin e Shëndetësisë.
3. Ky komision ka mandat dy (2) vjet.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit dhe Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale në Komunën e Rahovecit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të Komisionit,
- Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,
- Njesisë së Burimeve Njerëzore, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës - Presednik Opštine - Municipal Mayor

KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSIEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 5090 Nr. i faq/Br.str/No.pg 11

Data/Datum/Date 9 / 12 / 24

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017 dhe propozimit të Përgjegjës të Njesisë Kërkuese dhe Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit, kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: "Servisimi i pajisjeve mjekësore - ritenderim", me numër të kontratës: 623-23-8427-2-2-1/C637, si në vijim:
 - 1.1.Elbunit Kryeziu, i sistemuar në punë dhe detyrat e punës U.D. Drejtor në QKMF "Dr. Fahredin Hoti" në Rahovec, **CAKTOHET** menaxher i Kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
 - 1.2. Saranda Sallteku, Drejtore e Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, **CAKTOHET** mbikëqyrëse e drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik, Rregulloren 01/2022 për Prokurimin Publik, Manualin për Përdorim të Modullit për Menaxhimin të Kontratës, si dhe të rregullave të tjera, të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e kontratës. Pas nënshkrimit të kontratës dhe të emërimit të Menaxherit të kontratës (MK), të gjitha përgjegjësitë, përveç kompetencës për të ndryshuar apo ndërprerë Kontratën, barten nga zyra e prokurimit të Menaxheri i Kontratës.
3. Përgjegjësitë e Menaxherit të Projektit/Kontratës janë:
 - 3.1. Menaxheri i kontratës do të menaxhojë obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuar në kontratë;
 - 3.2. Menaxheri i kontratës do të sigurojë se Operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë; dhe
 - 3.3. Menaxheri i kontratës do të bëjë vlerësimin e performancës së kontraktuesve për kontratat nën menaxhimin e tij.
4. Funksionet e Menaxherit të Projektit/Kontratës, janë:
 - 4.1. Në pajtim me Kapitullin V të Rregullores 01/2022 për Prokurimin Publik, pas pranimit të Njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, menaxheri i Kontratës, duhet të kyçet në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe duhet të fillojë me fazat e menaxhimit të Kontratës

nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Si fazë e parë, Menaxheri i kontratës brenda afatit, duhet të krijojë Planin për Menaxhim të kontratës, duke përdorur funksionin "Fillimi / mobilizimi i kontratës";

- 4.2. Menaxheri i kontratës, duhet të lexojë kushtet e kontratës dhe të përgatisë Planin e Menaxhimit të kontratës (PMK), i cili duhet të bie dakord me Operatorin Ekonomik;
 - 4.3. Të dorëzojë Planin e aprovuar të Menaxhimit të Kontratës, kërkesën (fletëporosinë) dhe Zotimin e mjeteve në Zyrë të Prokurimit, në mënyrë që zyra e prokurimit të nxjerrë urdhërblertjen;
 - 4.4. Pas pranimit të urdhërblertjes nga zyra e prokurimit, menaxheri i kontratës duhet të vendosë të dhënat në platformën elektronike, të ngarkojë në platformën elektronike urdhërblertjen dhe ta përcjellë përmes platformës tek OE-ja, nga e cila datë fillon numërimi i afatit kohor për liferim;
 - 4.5. Të sigurojë që Operatori Ekonomik i përmbush të gjitha obligimet e performancës, apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.6. Të sigurojë që Operatori Ekonomik e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.7. Të sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përmbush të gjitha pagesat dhe obligimet e tjera, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.8. Të sigurojë se ka kontroll adekuat të kostove, të cilësisë, dhe të kohës aty ku është e përshatshme;
 - 4.9. Të sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së kontratës;
 - 4.10. Të sigurojë që të gjithë regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, të mbahen dhe të arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës, në sistem të prokurimit elektronik;
 - 4.11. Të nxjerrë variacione apo urdhra për ndryshim, nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
 - 4.12. Të sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës, Departamentit të Prokurimit dhe ta marrë miratimin;
 - 4.13. Të menaxhojë dorëzimet e procedurave të pranimit të punëve, të mallrave dhe të shërbimeve;
 - 4.14. Të japë detaje të plota për ndonjë ndërprerje të propozuar të kontratës, Departamentit të Prokurimit; dhe
 - 4.15. Të dorëzojë raportet mbi progresin ose kompletimin e një kontrate, siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit, ose nga ZKA-ja.
5. Përgjegjësitë e Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, janë:
- 5.1. Monitorimi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës; dhe
 - 5.2. Rishikimi, aprovimi dhe procesimi i vlerësimit të performancës së kontraktuesit – vlerësime të propozuara nga menaxherët e kontratave, nën mbikëqyrjen e tij.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- *Menaxheri i kontratës,*
- *Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,*
- *Spektori i Prokurimit, dhe*
- *Arkivi.*


Smajl Latifi
Kryetar i Komunës
Zyrtar Kryesor Administrativ



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PRESEDNIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 5091 Nr. i faq./Br.str./No.pg 12

Data/Datum/Date 10 / 12 / 24

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të neneve 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, në përputhje me nenet 10, 12, 34, 35 dhe 86 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 74 dhe nenin 92, paragrafin 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, të datës 29.3.2017, kryetari i Komunës së Rahovecit, nxjerr këtë:

V E N D I M

PËR THJESHTËZIMIN E SHËRBIMEVE NË KOMUNËN E RAHOVECIT

1. Me këtë vendim synohet thjeshtëzimi i shërbimeve të cilat ofrohen nga drejtoritë përkatëse të Komunës së Rahovecit.
2. Në të gjitha rastet kur qytetari bën kërkesë për një shërbim administrativ, për nxjerrjen e të cilit kërkohet një dokument që lëshohet nga e njëjta drejtori apo nga një drejtori tjetër e komunës, zyrtari përkatës i komunës obligohet që dokumentin e tillë të mos e kërkojë nga pala.
3. Nëse dokumenti i lëshuar nga komuna kërkohet si kopje, atëherë zyrtari përkatës kërkon dokumentin për shikim nga pala, dokumenti kopjohet nga ana e zyrtarit dhe vendoset në dosje. Nëse dokumenti i lëshuar nga komuna kërkohet origjinal, atëherë zyrtari përkatës e nxjerr dhe e vendos në dosje, por nuk e kërkon nga pala.
4. Të gjitha shërbimet administrative për nxjerrjen e të cilave kërkohen dokumente mbështetëse që lëshohen nga e njëjta drejtori apo nga një drejtori tjetër e komunës, janë të paraqitura në shtojcën 1 të këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi dhe zbatohet nga data 1 janar 2025.

Vendimi u dërgohet:

- Të gjitha drejtorive komunale që ofrojnë shërbimet sipas shtojcës 1,
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe
- Zyrës së Kryeministrit





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presidenti Opštine – Municipal Mayor



Njësia Nr./Br./No 02/Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 5092 Nr. i faq./Br.str./No.pg 12

Data/Datum/Date 10 / 12 / 24

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenin 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 36 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 1/2023"), nenit 7 paragrafi 2 dhe paragrafi 4 i Rregullores (QRK) Nr. 07/2023 për kompensimin për kujdestari, punën gjatë natës dhe punën jashtë orarit të punës, nenit 74 dhe nenin 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Me këtë vendim **AUTORIZOHET** nëpunësja civile Bjondina Ramaj, e sistemuar në punë dhe në detyra të punës: Zyrtare e lartë për Mbrojtje të Mjedisit, në Drejtorinë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit në Komunën e Rahovecit që të punojë jashtë orarit të rregullt të punës nga data 03.01.2025, për shkak të shtimit të vëllimit të punëve si koordinatorë e Grupit Punues për performancë komunale.
2. E lartpërmendura në pikën 1 të këtij vendimi ka të drejtë kompensimi për punën shtesë jashtë orarit të punës dhe atë 30% në orë për punën jashtë orarit të rregullt gjatë ditëve të punës dhe 50% në orë për punën gjatë fundjavës dhe festave zyrtare.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Zyra e Personelit dhe Drejtoria për Buxhet dhe Fiananca në Komunën e Rahovecit.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Me vendimin me Nr. Prot. 02/435 i datës 07.04.2023 është caktuar grupi punues për performancë komunale në Komunën e Rahovecit, në të cilin nëpunësja civile Bjondina Ramaj është caktuar koordinatorë e grupit punues, e cila është e obliguar që të bëjë mbledhjen, pranimin, verifikimin dhe publikimin e të dhënave të siguruar nga drejtoritë dhe sektorët përkatës sipas indikatorëve, në sistemin e menaxhimit të performancës komunale, duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-103 për Sistemin e Menaxhimit të Performancës së Komunave dhe Skemën e Grantit të Bazuar në Performancë.

Andaj, duke marrë parasysh se e lartpërmendura si në dispozitiv të këtij vendimi duhet të punojë edhe jashtë orarit të rregullt të punës, e njëjta ka të drejtë kompensimi për punën shtesë jashtë orarit të punës, dhe atë 30% në orë për punën jashtë orarit të rregullt gjatë ditëve të punës dhe 50% në orë për punën gjatë fundjavës dhe festave zyrtare, sipas legjislacionit në fuqi, duke u bazuar në nenin 36 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik dhe konform nenit 7 paragrafi 2 dhe paragrafi 4 i Rregullores (QRK) Nr. 07/2023 për kompensimin për kujdestari, punën gjatë natës dhe punën jashtë orarit të punës. Andaj, nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Me vendim të njoftohen:

- E lartpërmendura,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- Njësia e Personelit, dhe
- Arkivi.






Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 3095 Nr. i faq./Br.str/No.pg 12

Data/Datum/Date 11 / 12 / 24

RAHOVEC/ORAHOVAC

Komisioni Komunal për Riintegrim, bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe neni 44, paragrafi 1, nënparagrafi 4.1 dhe paragrafi 5, neni 21, paragrafi 1, 2 dhe 4, dhe neni 33, paragrafi 1, paragrafi 2 dhe 6, u vendos si në dispozitiv të Rregullores së QRK-së, nr. 22/2020, për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, mbështetur në vendimin e kryetarit të Komunës së Rahovecit, Nr. 271, të datës 14.7.2014, për themelimin e Komisionit Komunal për Riintegrim, në harmoni me Ligjin Nr. 05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nxjerr:

V E N D I M

APROVOHET kërkesa e [REDAKTUAR] i riatdhesuar nga Sllovenia me datë 16.10.2024, për mbështetje nga Masat Emergjente të Riintegrit. Mbështetja do të përfshijë:

1. **Asistencën dimërore**, në bazë të QRK 22/2020, Neni 22, pika 2, që përfshinë 5m³ dru për ngrohje. Kjo ndihmë u dedikohet familjeve të riatdhesuara gjatë sezonit të dimrit, të cilat, sipas kushteve të tyre të banimit, kanë mundësi të shfrytëzojnë lëndët djegëse për ngrohje.
2. Përfitues nga pika 1 e këtij vendimi është i vetëm (1) – anëtar nga [REDAKTUAR]
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Ministria e Punëve të Brendshme.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Komisioni Komunal për Riintegrim, në mbledhjen e mbajtur më **13.11.2024**, ka shqyrtuar kërkesën e [REDAKTUAR] i riatdhesuar më **16.10.2024** nga Sllovenia, dhe ka konstatuar se ai i plotëson kushtet për mbështetje nga masat emergjente, sipas Rregullores QRK nr. 22/2020.

[REDAKTUAR] posedon shtëpi banimi dhe nuk ka nevojë për akomodim. Ai jeton në kushte modeste dhe është kthyer gjatë periudhës dimërore. Në përputhje me Nenin 22, pika 2 të Rregullores, i takon përfitimi i asistencës dimërore prej **5m³ dru zjarri**, që është thelbësore për ngrohje dhe për të lehtësuar integrimin e tij të mëtejshëm.

Gjithashtu, bazuar në **Nenin 20** të Rregullores, [REDAKTUAR] ka të drejtë të përfitojë asistencë emergjente, përfshirë një pako tre (3) mujore ushqimore, higjienike dhe materiale, për të përballuar nevojat fillestare pas kthimit.

Këto masa janë të rëndësishme për të mbështetur riintegrimin e tij në mënyrë të qëndrueshme. Komisioni, duke u bazuar në dokumentacionin dhe rregulloren përkatëse, ka vendosur si në dispozitiv.

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur, në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh pas pranimit të tij, mund të paraqesë ankesë në Komisionin e Ankesave.

Vendimi u dërgohet:

1. [REDACTED]
2. Koordinatorit Rajonal të MPB-së,
3. Zyrës Komunale për Kthim dhe Komunitete, dhe
4. Arkivit të Komunës.

Smajl Latifi

Kryetar i Komunës



Rahovec, 11.12.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit

Opština Oraševac / Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 5096 Nr. i faq./Br.str/No.pg 12

Data/Datum/Date 11 / 12 / 24

RAHOVEC / ORAŠEVAC

Komisioni Komunal për Riintegrim, bazuar në nenin 13 të ligjit për vetëqeverisje lokale dhe neni 44, nën paragrafi 4.1 dhe paragrafi 5, neni 21, paragrafi 2 dhe 6, dhe neni 47, paragrafi 1, nenparagrafi 1.11, andaj u vendos si në dispozitivin të Rregullores të QRK nr. 22/2020 për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, mbështetur në Vendimin e Kryetarit të Komunës së Rahovecit Nr. 271 të datës 14.07.2014 për themelimin e Komisionit Komunal për Riintegrim, në harmoni me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nxjerr:

V E N D I M

1. REFUZOHET kërkesa e [REDAKTUAR] e riatdhesuara nga Gjermania, pas ri-shqyrtimit nga komsioni i ankesave për rinitegrimin me nr. të vendimit: 998/2024 të datës 03/12/2024, mbi rishqyrtimin e lendes., për mbështetje nga Masat Emergjente të Riintegritit për vazhdim të akomodimit.

A r s y e t i m

Në seancën e mbajtur më datë 09/12/2024, Komisioni Komunal për Riintegrim ka shqyrtuar kërkesën/vendimin e Komisionit të Ankesave për Riintegrim nga Ministria e Punëve të Brendshme, me nr. të vendimit 998/2024 të datës 03/12/2024, lidhur me mbështetjen për vazhdimin e akomodimit me qira për [REDAKTUAR] një e riatdhesuar nga Komuna e Rahovecit, e cila aktualisht jeton në Prishtinë.

Pas shqyrtimit të detajuar, Komisioni ka marrë një vendim bazuar në faktet dhe rregulloret në fuqi si më poshtë:

Mungesa e përmbushjes së kriterëve ligjore sipas Rregullores QRK nr. 22/2020

- Neni 33 i kësaj rregulloreje përcakton se mbështetja për akomodim me qira mund të vazhdohet vetëm për individët që konsiderohen **persona të cënueshëm**, siç janë rastet me nëna vetëushqyese ose viktimat të dhunës.
- [REDAKTUAR] nuk përmbush më kriterin e të qenit nënë vetëushqyese pasi fëmijët e saj kanë arritur moshën madhore.
- Komisioni ka konstatuar gjithashtu se ajo nuk mund të klasifikohet si viktimë e dhunës pafundësisht bazuar në rrethanat e saj familjare dhe duke u bazuar që fëmijët e saj janë të moshës madhore dhe të aftë për punë, duke qenë se martesa e parë e saj ka qenë në Komunën e Malishevës dhe nuk lidhet me Rahovecin. Nëse si komunë i kemi ofruar në të kaluarën akomodim mirëpo familja e ka refuzuar një gjë të tillë.

Mungesa e lidhjes juridike dhe administrative me Komunën e Rahovecit

- [REDAKTUAR] nuk është banorë e Komunës së Rahovecit dhe aktualisht jeton në Prishtinë.
- Zyra për Punë Sociale e Rahovecit, bazuar në kompetencat e saj dhe ligjet në fuqi, nuk ka mundësi të lëshojë raportime apo anamneza për një person që nuk është rezident dhe që ka refuzuar të jetojë në territorin e komunës.

Përputhshmëria me rregulloren dhe qëndrimet e komisionit

- Kërkesa bie ndesh me kriteret e Rregullores QRK nr. 22/2020. Për rrjedhojë, [REDACTED] nuk ka të drejtë të përfitojë mbështetje nga Masat Emergjente të Riintegritit për akomodim me qira.

Përfundimi:

Bazuar në të gjitha rrethanat dhe vlerësimet e komisionit, kërkesa e [REDACTED] është refuzuar. Vendimi i komisionit është përfundimtar dhe i bazuar në parimet ligjore dhe procedurat e përcaktuara.

[REDACTED] ka të drejtën të paraqesë ankesë në organet përkatëse brenda afateve të përcaktuara ligjore, nëse konsideron se vendimi nuk është i drejtë.

Vendimi u dërgohet:

1. [REDACTED]
2. Koordinatorit Rajonal të MPB,
3. Zyrës Komunale për Kthim dhe Komunitete, dhe
4. Arkivit të Komunës.

Smail Latifi


Kryetar i Komunës



Rahovec, 11.12.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Duke u bazuar në nenin 13 dhe nenin 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008") dhe nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për emërimin e personave zyrtar, autorizues, zotues, certifikues, pranimeve për administratë, shëndetësi dhe arsim për vitin 2025

1. Me këtë vendim **Emërohen** personat zyrtar, autorizues, zotues, certifikues, pranimeve për administratë, shëndetësi dhe arsim për vitin 2025, në këtë përbërje:

1.1 Zyrtar/e Autorizues/se për listën e pagave:

- Afrim Limani- kryesor
- Besnik Hoti- zëvendës

1.2 Zyrtar/e Autorizues për paga në Shëndetësi:

- Saranda Sallteku – kryesor
- Elbunit Kryeziu – zëvendës

1.3 Zyrtar/e Autorizues për paga në Arsim:

- Avni Morina – kryesor
- Saranda Sallteku – zëvendëse

1.4 Zyrtar/e Autorizues i Shpenzimeve:

- Perparim Krasniqi – kryesor
- Berat Duraku – zëvendës

1.5 Zyrtar/e Autorizues i Shpenzimeve për Shëndetësi:

- Saranda Sallteku – kryesor
- Elbunit Kryeziu – zëvendës

1.6 Zyrtar/e Autorizues i Shpenzimeve për Arsim:

- Avni Morina – kryesor
- Jeton Krasniqi – zëvendës

1.7 Zyrtar Autorizues për urdhër Blerje - proces order:

- Astrit Mullabazi – kryesor

1.8 Zyrtar/e Zotues:

- Mimoza Ejupi – kryesore
- Ardian Rama – zëvendës

1.9 Zyrtar/e Certifikues:

- Esat Hoti - kryesor
- Ardian Rama - zëvendës

1.10 Zyrtar/e i Nënaloitimeve për Arsim:

- Lulzim Krasniqi – kryesore
- Egzon Thaqi – zëvendës

1.11 Zyrtar/e i Shpenzimeve:

- Zyber Thaqi - kryesor
- Egzon Thaqi - zëvendës

1.12 Zyrtar/e i Pranimeve:

- Qëndresë Kryeziu Hoxha-kryesore
- Pajtim Haxhijaha- zëvendës

1.13 Zyrtar/e autorizues të shpenzimeve për arsim (shkollat);

- Drejtorat e shkollave - kryesor
- Avni Morina - zëvendës
- Jeton Krasniqi - zëvendës

2. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me Nr. Prot. 02/3911 i datës 1.3.2024 i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin me Nr. Prot. 02/ 4652 i datës 26.8.2024.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- *Zyrtarët e emëruar,*
- *Drejtoria për Buxhet dhe Financa,*
- *Zyra e Prokurimit, dhe*
- *Arkivi.*






Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit



Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 21 dhe 26 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 11 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Për qasje në dokumente publike

1. **Miratohet** e bazuar kërkesa me Nr. Prot. 02/5066/24, e datës 4.12.2024 për qasje në dokumente publike nga Organizata Iniciativa për Progres (INPO), dhe i ofrohet qasje e **plotë** në dokumente publike, dhe atë në:

1.1. Informacionet dhe dokumentet me detaje të projektit “Ndërtimi i ballkonit Panoramik mbi qytetin e Rahovecit”, me numër prokurimi: 623-24-5662-5-2-1.

2. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Në mbështetje të nenit 10 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike (QDP), Komuna e Rahovecit ka pranuar kërkesën me Nr. Prot. 02/5066/24, e datës 4.12.2024 për qasje në dokumente publike nga Organizata Iniciativa për Progres (INPO), për qasje në dokumente publike. Pas shqyrtimit të kërkesës, të njëjtit i ofrohet qasje e **plotë** në dokumente publike dhe atë në: Informacionet dhe dokumentet me detaje të projektit “Ndërtimi i ballkonit Panoramik mbi qytetin e Rahovecit”, me numër prokurimi: 623-24-5662-5-2-1.

Kërkesa për Qasje në Dokumente Publike është pranuar në mënyrë elektronike.

Komuna e Rahovecit, pas shqyrtimit të kërkesës, si dhe pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të paraqes ankesë në Agjencionin për Informim dhe Privatësi brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data e pranimi të tij.

Vendimi u dërgohet:

- Znj. Blerta Gashi, Zyrtare për shqyrtimin fillestar të QDP,
- Organizata Iniciativa për Progres (INPO), dhe
- Arkivit.

